



**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**SPITALI RAJONAL DURRËS**

NR. Prot \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Blerje barna ndare ne 7 lote “/ Marreveshje kuader me disa Operator Ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara”.(Nje Oe i vetem fitues per secilin Lot)

**Blerje Barna per SRD-ne, e ndarë në 7 Lote.**

Nr	Sistemi	Lenda vepruese	Forme doza	Paketimi
Lot 1	Anestezi Reanimacion	Thiopental sodium	1 gr	Box x 1 vial
Lot 2	Sistemi kardiovaskular	Nebivolol	5mg	Box x 30 tablets
Lot 3	Anti-infektive te pergjithshem	Human Rabies Immunoglobulin	150 UI/ml - 2ml	
Lot 4	Anti-infektive te pergjithshem	Amoxicillin + Clavulanic Acid	1gr + 200 mg	
Lot 5	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	150 mg/3 ml	Box x 6 ampoules x 3ml
Lot 6	Gjaku dhe organet formuese te gjakut	Phytomenadion (Vitamin K)	10mg/1ml	Box x 5 ampoules x 1ml
Lot 7	Sistemi muskuloskeletik	Suxamethonium chloride	100 mg	Box x 1 glass vial

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Artikuj Farmaceutike-33600000-6*

**I. Fondi limit / vlera e pritshme e kontratave : Fondi Limit /vlera e pritshme e kontratave ne total per 7- lote per proceduren Blejre Barna per 24 muaj parashikohet ne vleren: 5,126,147.43 ( pesemilion e njeqind e njezet e gjashtemije e njeqind e dyzet e shtate pike dyzet e tre ) Leke pa TVSH**

**Fondi limit per Lotet:**

**Loti 1 Thiopental sodium** fondi limit /vlera e pritshme e kontratave ne total : **408,140** (Katerqind e tetemije e njeqind e dyzet) leke pa tvsh

**Loti 2 Nebivolol** **fondi limit** /vlera e pritshme e kontratave ne total :**38,520** (Tridhjet e tetemije e peseqesind e njezet) leke pa tvsh

**Loti 3 Human Rabies Immunoglobulin** fondi limit /vlera e pritshme e kontratave ne total: **2,886,441.48** ( Dymilion e teteqind e tetedhjet e gjashtemije e katerqind e dyzet e nje pike dyzet e tete) leke pa tvsh

**Loti 4 Amoxicillin + Clavulanic Acid** fondi limit /vlera e pritshme e kontratave ne total : **172,253.95** ( Njeqind e shtatedhjet e dymije e dyqind e pesedhjet e tremije pike nentedhjet e pese) leke pa tvsh

**Loti 5 Amiodarone** fondi limit /vlera e pritshme e kontratave ne total: **73,032** ( Shtatedhjet e tremije e tridhjet e dy) leke pa tvsh

**Loti 6 Phytomenadion (Vitamin K)** fondi limit /vlera e pritshme e kontratave ne total: **490,800** ( Katerqind e nentedhjet mije e teteqind) leke pa tvsh

**Loti 7 Suxamethonium chloride** fondi limit /vlera e pritshme e kontratave ne total: **1,056,960** ( Nje million e pesedhjet e gjashtemije e nenteqind e gjashtedhjet) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Durres** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **(TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. **Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. **Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;**

**Argumentimi:** Kjo shtojce është pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

c. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3:**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 8:**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen është e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

---

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: (TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)**

Kopje te deklarave te xhiros vjetore per tre vitet e fundit 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e perriudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40% e findit limit/vleres se pritshme te kontratave , te lotit apo shumes se loteve per te cilen konkuron operatori ekonomik.

**Argumentimi:** Ky kriter, është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një **xhiro vjetore minimale** të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në **bilancet** e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet

*aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”; si dhe ne piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimimi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së perlllogaritur të kontratës ose lotit në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulet monetar.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 i ndryshuar ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

**Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimimi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;*** si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

---

### **2.3 Kapaciteti teknik: (TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)**

#### **1) Deklarate per origjinen e mallit, ku te percaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese.**

*Argumentimi:* Ky kriter eshte ne perputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik si dhe ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi. Kërkimi i dokumentit që parashikohet në 1 të kapacitetit teknik është ne perputhje me ligjin perkates per barnat dhe sherbimin farmaceutik.

#### **2) Per barnat (e listes se DST) te autorizuar per tregtim ne Republiken e Shqiperise duhet te paraqitet dokument leshuar nga Agjencia Kombetare e Barnave dhe Pajisjeve**

**Mjekesore qe bari i ofertuar eshte i pajisur me autorizim per tregtim ne RSH ose certifikate regjistrimi i barit per tregtim ne RSH brenda afatit te vlefshmerise.**

**Argumentimi:** Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 2 dhe 4, te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", si dhe ne baze te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar, neni 40 pika 5 a) Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/ enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose... dhe nenin 11 dhe 18 te Ligjit nr.105/2014 "Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik" te ndryshuar. Kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken 2 te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat.

**3) Per barnat e (e listes se DST) te paautorizuara per tregtim ne Republiken e Shqiperise bari qe ofrohet duhet:**

- Te kete marre autorizim per tregtim dhe te qarkulloje ne njerin nga vendet e Bashkimit Europian,Shteteve te Bashkuara te Amerikes, Kanada, Turqi, Zvicer, Izrael, Japoni, Australi: ose
- Te jete i prodhuar ne vendet e Ballkanit, vetem kur ka marre autorizim per tregtim dhe qarkullon ne vendin e tyre, ose
- Te jete i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vleresimit te Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit per Ushqim dhe Barnat (FDA) i Shteteve te Bashkuara te Amerikes.

**Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:**

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme, ose që disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA.

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.

**Argumentimi:** Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 2 dhe 4, te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", si dhe ne nenin 11/2, nenin 12 dhe ne nenin 14 teLigjit nr.105/2014 "Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik" te ndryshuar., ne pikes 5 te nenit 44 te VKM nr. 285, "Per rregullat e prokurimit publik". Per sa me siper cituam, cmojme se kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken 3) te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat.

**4) Kerkohet Autorizim:**

Në rastin e parashikuar në pikën "2" të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori zyrtar i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jete i vlefshem per te gjithë periudhën e kerkuar.

Në rastin e parashikuar në pikën “3” të kritereve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori zyrtar i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje barnat e tyre. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

**Argumentimi:** Ky kriter gjen mbështetje në nenin 11 dhe në nenin 12 të Ligjit nr. 105/2014 “*Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik*” të ndryshuar. Duke qenë se për barnat e percaktuara tek pika 2) e kapaciteti teknik bëhet fjale për tregtim të barnave të autorizuar në vendin tone, atëherë dokumenti shoqëruar që e verteton këtë fakt është pikërisht Autorizimi për Tregtim nga mbajtësi i saj MAH (Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim). Për barnat e percaktuara tek pika 3) kapaciteti teknik bëhet fjale për tregtim të barnave të paautorizuara në vendin tone, atëherë dokumenti shoqëruar që kërkohet është Autorizimi për Tregtim nga mbajtësi i MAH (Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim) ose Autorizim Prodhuesi nga i cili janë prodhuar barnat për të cilat një operator ekonomik oferton. Në këtë rast Autorizimi i Prodhuesit është nga vendi prodhues që e autorizon subjektin të tregtojë barnat objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi nga Prodhuesi është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues, gjithashtu vendosja e këtij kriteri gjen mbështetje edhe tek pika 4, nën 77, e Ligjit nr. 162/2020, “*Per Prokurimin Publik*” si dhe në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 “*Mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik*” Për sa me sipër cituam, cmojmë se kërkimi i dokumentit që parashikohet në pikën ç) të kapacitetit teknik është në përputhje me ligjin përkatës për barnat

**5) Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose / jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.**

**Argumentimi:** Ky kriter gjen mbështetje në Ligjin nr. 105/2014 “*Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik*” të ndryshuar ku përcaktohet që bari për përdorim në RSH duhet të jete brenda afatit të skadencës për tregtim.

**6) Paketimi:** Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar emri i barit, formë - doza, kodi i barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadencës, nr. i serisë, si edhe përveç pullës së kontrollit të barnave të aplikuar në paketimin e jashtëm/ kutinë e ambalazhit të tyre, barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin “**PËRDORIM SPITALOR - NDALOHET SHITJA**”

**Argumentimi:** Ky kriter gjen mbështetje në nenin 4, pika 38/b të Ligjit nr. 162/2020, “*Per Prokurimin Publik*”, nën 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, në Ligjin nr.105/2014 “*Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik*” të ndryshuar nën 49 dhe nën 20 ku përcaktohet që të gjitha barnat e prodhuara në vend, me destinacion tregun e brendshëm, si dhe barnat që importohen, me destinacion tregun vendas, duhet të kenë detyrimisht të aplikuar në paketimin e jashtëm pullën e kontrollit të barnave si dhe në Urdherin Nr.287 datë 12.07.2011 “*Per paisjen me vule të barnave që perdoren në institucionet shëndetësore publike*” i cili përcakton që barnat që qarkullojnë në sistemin shëndetësor public

pervec pulles se sigurise duhet detyrimisht te jene te vulosura edhe me vulen me mbishkrimin “Perdorim spitalor-Ndalohet shitja”

**7) Formë – doza dhe volume për secilin bar është përcaktuar dhe është detyruese.**

Forme – doza eshte vendosur duke iu referuar percaktimeve te publikuara ne Regjistrin e Barnave nga Qendra Kombetare e Barnave dhe e Pajisjve Mjekesore.

**8) Afatet e Levrimit te mallit:**

Sipas nevojave te autoritetit kontraktor

**Ky kriter dhe ky argumentim eshte bere dhe eshte vendosur ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike me nr. 1587/2 prot., dt. 05.12.2024 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 1587/1 prot., dt. 25.11.2024.**

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Shtojca 5.**

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**(TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)**

Nr	Sistemi	Lenda vepruese	Forme doza	Paketimi	Njesia
1	Anestezi Reanimacion	Thiopental sodium	1 gr	Box x 1 vial	Flakon
2	Sistemi kardiovaskular	Nebivolol	5mg	Box x 30 tablets	Tablete
3	Anti-infektive te pergjithshem	Human Rabies Immunoglobulin	150 UI/ml - 2ml		Flakon
4	Anti-infektive te pergjithshem	Amoxicillin + Clavulanic Acid	1gr + 200 mg		Flakon
5	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	150 mg/3 ml	Box x 6 ampoules x 3ml	Ampule
6	Gjaku dhe organet formuese te gjakut	Phytomenadion (Vitamin K)	10mg/1ml	Box x 5 ampoules x 1ml	Ampule
7	Sistemi muskuloskeletik	Suxamethonium chloride	100 mg	Box x 1 glass vial	Flakon

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar

ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

**Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose / jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.**

**Paketimi:** Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar emir i barit, formë - doza, kodi i barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadencës, nr. i serisë, si edhe përveç pullës së kontrollit të barnave të aplikuar në paketimin e jashtëm/ kutinë e ambalazhit të tyre, barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin **“PËRDORIM SPITALOR - NDALOHET SHITJA”**

**Formë – doza dhe volume për secilin bar është përcaktuar dhe është detyruese.**

Forme – doza është vendosur duke iu referuar përcaktimeve të publikuara në Regjistrin e Barnave nga Qendra Kombëtare e Barnave dhe e Pajisjve Mjekësore

### **Afatet e Levrimit të mallit:**

Sipas nevojave të autoritetit kontraktor

**Argumentimi për specifikimet teknike janë vendosur në bazë të materialit të përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit me nr. 1587/2 prot., dt. 05.12.2024 të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdherin e brendshëm me nr. 1587/1 prot., dt. 25.11.2024 si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nënvepset 20 dhe 49 të Ligjit nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”.**

## **SHTOJCA 6**

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT (TE NJEJTA PËR TE GJITHA LOTET)**

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas tabelës së mëposhtme.

Afatet e lëvrimit: Levrimi i medikamenteve të behet sipas kërkesave të AK.

Nr	Sistemi	Lenda vepruese	Forme doza	Paketimi	Njesia	Sasia sipas planifikimit për 24 muaj	fondi limit



2	Anestezi Reanimacion	Thiopental sodium	1 gr	Box x 1 vial	Flakon	2000	408,140.00
8	Sistemi kardiovaskular	Nebivolol	5mg	Box x 30 tablets	Tablete	3600	38,520.00
9	Anti-infektive te pergjithshem	Human Rabies Immunoglobulin	150 UI/ 2ml		Flakon	100	2,886,441.48
10	Anti-infektive te pergjithshem	Amoxicillin + Clavulanic Acid	1gr + 200 mg		Flakon	1200	172,253.95
14	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	150mg/3 ml	Box x 6 amp x 3ml	Ampule	1200	73,032.00
16	Gjaku dhe organet formuese te gjakut	Phytomenadion (Vitamin K)	10mg/1ml - 1 ml	Box x 5 ampoules x 1ml	Ampule	4800	490,800.00
17	Sistemi muskuloskeletik	Suxamethonium chloride	100 mg	Box x 1 glass vial	Flakon	4800	1,056,960.00

**Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike dhe perllogaritjes se fondit limit me nr. 1587/2 prot., dt. 05.12.2024 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 1587/1 prot., dt. 25.11.2024, si dhe ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e levrimit të mallrave.**

**U ngarkua ne sistemin e prokurimit elektronik nga njesia e prokurimit:**